

Aksion i Daikin "Sondazh për vlerësimin e kënaqësisë së konsumatorëve"

1. **Daikin Airconditioning Central Europe** ("Organizatori / Daikin Airconditioning Central Europe"), po realizon një Sondazh për vlerësimin e kënaqësisë së konsumatorëve ndërmjet 1.04.2019 - 31.10.2019 si një aktivitet promocional.

2. Aktiviteti " Sondazh për vlerësimin e kënaqësisë së konsumatorëve" ("Aksioni") do të realizohet në pajtueshmëri me kushtet të cilat janë obligues për të gjithë pjesëmarrësit.

Me pjesëmarrjen në këtë Aksion, pjesëmarrësit pajtohen t'i respektojnë kushtet dhe rregullat e tij.

3. Organizatori e ruan të drejtën, gjatë realizimit të aksionit, për të vazhduar kohëzgjatjen e Aksionit, ashtu siç është përcaktuar në Nenin 1 të këtyre Kushteve dhe Rregullave, por jo para se ta bëjë publike atë, duke i vënë në dispozicion informacionet e përditësuara për çdo person të interesuar në pajtim me mënyrën e theksuar në Nenin 4 dhe nenin 19 të këtyre Kushteve dhe Rregullave.

Kushtet dhe Rregullat e Aksionit

4. Aksioni do të ndodh ndërmjet 1 prillit 2019 dhe 31 tetorit 2019 në faqen e internetit të Daikin: www.daikin.al.

Kushtet dhe rregullat që vlejnë gjatë organizimit dhe realizimit të aksionit janë falas për çdo kandidat gjatë fushatës, në faqen e internetit të Daikin, e cila është në dispozicion në linkun vijues: www.daikin.al.

Organizatori e ruan të drejtën për të ndryshuar dhe/ose plotësuar këto kushte dhe rregulla, mirëpo vetëm në qoftë se pjesëmarrësit njoftohen paraprakisht për çdo ndryshim të ndonjë dispozite të tyre. Të gjitha ndryshimet/plotësimet e këtyre kushteve dhe rregullave do të përmbahen në plotësimet të cilat do t'i jenë të qasshme opinionit publik përmes përditësimit të kushteve dhe rregullave në mënyrën e përshkruar në paragrafin më parë.

E drejta e pjesëmarrjes

5. Të gjithë konsumatorët e Daikin mund të marrin pjesë në këtë Aksion, edhe të rinjtë edhe ato ekzistues, në qoftë se i plotësojnë në mënyrë të akumuluar kushtet vijuese:

5.1. I plotësojnë kushtet e përcaktuara në Nenin 6 të këtyre Kushteve dhe Rregullave.

5.2. Kanë blerë së paku një kondicioner ajri split ose multi-split ose një pompë ngrohjeje Altherma për qëllime/përdorim banesor, ndërsa blerja të jetë bërë nga 1 janari 2018 e këtej.

5.3. Mund të dëshmojnë blerjen e prodhimit të Daikin me paraqitjen e faturës që korrespondon me këtë prodhim me datë nga 1 janari 2018 deri 31 tetori 2019. Do të paraqiten vetëm faturat e lëshuara

për individë, ndërsa faturat e lëshuara për persona juridik nuk do të merren parasysh për pjesëmarrje në këtë aksion.

DHE

5.4. I janë përgjigjur pyetjeve të pyetësorit në internet në www.daikin.al gjatë realizimit të këtij Aksioni, përkatësisht ndërmjet 1.04.2019-31.10.2019.

"Konsumatorët me të drejtë pjesëmarrje"

6. Kategoritë vijuese të konsumatorëve nuk mund të marrin pjesë në këtë Aksion:

- Personat që nuk kanë arritur moshën madhore 18 vjet në datën e regjistrimit në këtë Aksion;
- Punonjësit tek organizatori, punonjësit e kompanive të përfshirë në rrjetin e distribuimit të Daikin, si dhe pjesëtarët e familjeve të tyre (bashkëshortët, prindërit, motër/vëlla, fëmijë) nuk mund të marrin pjesë në këtë Aksion.

Gjatë identifikimit të personave që kanë ndikuar ose e kanë lehtësuar akordimin e çmimeve nga ky Aksion nga persona që nuk i plotësojnë kushtet për pjesëmarrje në Aksion, të përcaktuara me këto Kushte dhe Rregulla, organizatori ka të drejtë, në gjyq, të kërkojë kthimin e parave edhe nga personat që e kanë lehtësuar pjesëmarrjen e të tjerëve në këtë Aksion edhe nga personat që kanë marrë pjesë në aksionin në mënyrë të parregullt.

Organizatori e ruan të drejtën të anulojë çdo pjesëmarrje në këtë aksion, e cila është në kundërshtim me këto Kushte dhe Rregulla, dhe njëkohësisht të mos ua akordojë çmimet pjesëmarrësve që i kanë shkelur kushtet e theksuara në këto Kushte dhe Rregulla. Për çdo veprim në drejtim të anulimit ose mos-akordimit të çmimeve për shkak të arsyeve të sipërpërmendura, pjesëmarrësi do të njoftohet përmes e-mailit.

Çmimet

7. Çmimet janë prodhime të Apple iPad II.

Në këtë aksion, gjithsej do të akordohen 2 çmime.

Çmimet do të akordohen sipas mekanizmave të përcaktuara në pjesën "Mekanizmi i Aksionit" të këtyre Kushteve dhe Rregullave.

Një pjesëmarrës mund të fitojë vetëm një çmim nga ky Aksion. Në qoftë se pjesëmarrësi e ka plotësuar disa herë pyetësorin për fidbek në internet, do të konsiderohet vetëm një herë gjatë shortit të çmimeve.

Organizatori e ruan të drejtën e tij për të shkëmbyer çmimin, gjatë aksionit, me një version të ri, në qoftë se gjatë akordimit të prodhimit të cekur "Apple iPad II" nuk është më në dispozicion.

Mekanizmi i Aksionit

8. Mekanizmi i Fushatës.

Për të marrë pjesë në këtë Aksion, konsumatorët me të drejtë pjesëmarrjeje duhet t'i plotësojnë kushtet në vijim:

8.1 Të jenë regjistruar për pyetësin për fidbek (komente kthyes) i qasshëm në linkun: www.daikin.al dhe t'u janë përgjigjur të gjitha pyetjeve, veçanërisht gjatë periudhës së Aksionit, përkatësisht ndërmjet 1.04.2019 - 31.10.2019.

Gjatë regjistrimit, pjesëmarrësi do të duhet ta jep emrin dhe e-mail adresën për kontakt, si dhe mund të ofrojë dhe dokumentin që vërteton blerjen e prodhimit të Daikin. Nëse pjesëmarrësi vendos që të mos e ngarkoj këtë dokument në këtë fazë, atëherë ai do të jetë i obliguar t'ia dorëzojë atë organizatorit jo më vonë se 4 nëntori 2019, ndryshe pjesëmarrja nuk do të konsiderohet si e vlefshme gjatë tërheqjes së çmimeve më datë 12 Nëntor 2019.

Pjesëmarrësit deklarojnë se të dhënat e siguruar në çastin e regjistrimit për plotësimin e pyetësit për fidbek në internet janë të sakta dhe kanë për detyrim të mos shfrytëzojnë të dhëna që i përkasin të tjerëve me qëllim rritjen e shanseve për të fituar çmimin. Në qoftë se organizatori zbulon çfarëdo lloj përpjekje për mashtrim në këtë drejtim, ai do ta diskualifikojë pjesëmarrësin dhe nëse tashmë është akorduar çmimi, do të kërkojë të kthehet çmimi, duke mos qenë përgjegjës për asnjë dëm të shkaktuar nga pjesëmarrësi si rrjedhojë e pretendimit. Në qoftë se fituesi e ka tjetërsuar me qëllim një personi të tretë, atëherë organizatori ka të drejtë të kërkojë dhe të merr nga pjesëmarrësi një vlerë të barabartë të çmimit të akorduar, siç është theksuar në Nenin 7 të këtyre Kushteve dhe Rregullave.

DHE

8.2. Është në gjendje të vërtetojë, deri më 3 nëntor 2019 më së voni, se prodhimi i Daikin është blerë në bazë të faturës ndërmjet datave 1.01.2018 deri 31.10.2019.

Dëshmia për blerjen e prodhimit të Daikin do të mund të sigurohet përmes dërgimit të një kopjeje të skanuar të faturës ose listës së garancisë me dokumente që e identifikojnë edhe personin edhe prodhimin e blerë nga pjesëmarrësi. Që të konsiderohet fatura për përfshirjen e pjesëmarrësit në lojën shpërblyese, është e nevojshme të identifikohen të gjitha të dhënat e siguruar gjatë regjistrimit për plotësimin e pyetësit dhe të dhënave në faturë.

8.3 Me plotësimin e pyetësit për fidbek në internet, çdo pjesëmarrës pajtohet, me vullnetin e tij/saj, që t'i sigurojë të dhënat e nevojshme personale dhe pajtohet që ato t'i vë në dispozicion të organizatorit me qëllim organizimin e pjesëmarrjes në këtë Aksion, shpalljen e fituesve, akordimin e çmimeve dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore, pa mos i shpallur ato palëve të treta (përveç nëse kjo nuk nevojitet për të zbuluar ato me qëllim organizimin e Aksionit, akordimin e çmimeve dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore). Në qoftë se pjesëmarrësit kanë dhënë pëlqim të veçantë, atëherë organizatori mund t'i shfrytëzojë të dhënat e tyre personale për marketing direkt në pajtueshmëri me dispozitat e Nenit 17, paragrafi 4 më poshtë.

9. Përcaktimi i fituesve

9.1. Në kuadër të këtij Aksioni, gjithsej do të akordohen 2 çmime të cilat do të jenë në formë të prodhimeve Apple iPads II, siç është përshkruar në Nenin 7.

9.2. Akordimi i çmimeve në kuadër të këtij Aksioni do të bëhet me tërheqje të rastësishme më datë 12 nëntor, 2019 me ndihmën e aplikacionit <https://www.random.org/>. Aplikacioni <https://www.random.org/> është një platformë online ku mund të gjenerohen të dhëna të rastësishme bazuar në informacionet e siguruar nga Organizatori.

Ndërmjet datës 4 nëntor dhe 12 nëntor 2019, Organizatori do ti fut emrat ose e-mail adresat e pjesëmarrësve të cilët i kanë plotësuar kushtet e mësipërme në pajtim me Nenin 8.1 në aplikacionin <https://www.random.org/>, e cila do të rezultojë në gjenerimin e 2 emrave ose e-mail adresave për përcaktimin e fituesve.

Çdo pjesëmarrës i caktuar si fitues, pas tërheqjes së organizuar në aplikacionin <https://www.random.org/c> do të pranojë një çmim të ofruar nga ky Aksion, i cili do të jetë 1 prodhim Apple Ipad II dhe do të shpallet nga Daikin Airconditioning Central Europe në përfundim të Aksionit, në pajtueshmëri me Nenin 14 më poshtë.

10. Shpallja dhe akordimi i çmimeve

10.1. Fituesit do të njoftohen në mënyrë individuale vetëm përmes e-mail adresës të cilën e kanë shënuar gjatë plotësimit të pyetësorit për fidbek online brenda 10 ditëve kalendarik nga dita e shpalljes zyrtare në faqen lokale të internet të Daikin në pajtim me Nenin 14 të këtyre Kushteve dhe Rregullave menjëherë pas tërheqjes, si dhe do të kërkohet prej tyre të theksojnë një adresë postare fizike në të cilën duan që ta pranojnë çmimin dhe numrin e telefonit për njoftimin e tyre.

10.2. Çmimet do të dërgohen nga një korier në llogari të Daikin Airconditioning Central Europe, në pajtueshmëri me kushtet e përgjithshme të përcaktuara nga korieri. Fituesi duhet të përgjigjet brenda 10 ditëve kalendarik pas pranimit të njoftimit individual në e-mail adresën e tij/saj. Në qoftë se fituesi nuk përgjigjet si më lartë, atëherë ai/ajo do ta humb të drejtën për të pranuar çmimin brenda 10 ditëve kalendarik pas pranimit të njoftimit individual. Në këtë rast, çmimi do të mbetet pronë e Organizatorit.

10.3. Organizatori nuk do të jetë përgjegjës për ato raste kur një fitues i caktuar nuk do të mund të kontaktohet për shkak se të dhënat që janë siguruar në çastin e regjistrimit në këtë Aksion plotësisht ose pjesërisht janë të pasakta.

11. Çdo fitues do ta pranojë çmimin në adresën e theksuar brenda 30 ditëve pas dorëzimit të të dhënave të nevojshme për dërgesën në Daikin Airconditioning Central Europe. Në qoftë se pjesëmarrësi nuk mund të gjendet në adresën e theksuar për dërgesën dhe nuk e merr paketën e dorëzuar nga korrieri, atëherë pjesëmarrësit i jepet afat 10 ditësh pas pranimit të njoftimit se mund ta pranojë paketën nga Qendra e pranimit të paketave, që është shënuar në vërtetimin e dërgesës, dhe ta merr çmimin atje. Daikin Airconditioning Central Europe nuk ka asnjë përgjegjësi për t'ia dërguar paketë, për së dyti, fituesit në rast të situatës së sipërpërmendur.

12. Çmimet do t'u akordohen pjesëmarrësve që e kanë plotësuar pyetësorin për fidbek online, që i kanë dorëzuar dokumentet e nevojshme për të dëshmuar blerjen e prodhimit (eve) në bazë të Nenit

8 më sipër, dhe fitojnë çmimet gjatë shortit, i cili do të mbahet ndërmjet datave 4 dhe 12 nëntor 2019, pa mos kërkuar ndonjë formalitet tjetër.

13. Fituesit nuk mund të kërkojnë para në kundërvlerë të çmimit.

14. Fituesit dhe çmimet e akorduara do të publikohen në faqen e Facebook-ut të Daikin: www.daikin.al, pas përfundimit të Aksionit dhe pas shortit, por jo më vonë se 20 nëntor 2019.

TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË

15.1. Daikin Airconditioning Central Europe nuk është përgjegjës për vonesën e dërgesës ose mos dërgesës së çmimeve kur ajo ndodh në rastet vijuese: a) çmimi nuk mund të merret ose sigurohet për shkak të dështimit të fituesit dhe/ose përfaqësuesit të tij për të identifikuar dhe/ose pranorë çmimin deri në afatin e caktuar ose për shkak të pengesave tjera teknike dhe/ose juridike të fituesit dhe/ose përfaqësuesit/agjentit të tij; dhe b) kur është e pamundur të dërgohet çmimi për shkak të ngjarjeve të forcës madhore, kufizimeve rregullatore ose juridike ose rrethanave të tjera.

15.2. Daikin Airconditioning Central Europe nuk është përgjegjës për pamundësinë e pjesëmarrjes në këtë Aksion për shkak të ndodhjes së ndonjë situatë jashtë kontrollit të tij – raste të forcës madhore, prishjes së rrjetit global të shërbimit të internetit të palës së tretë që janë jashtë kontrollit të organizatorit.

15.3. Daikin Airconditioning Central Europe nuk do të jetë përgjegjës për përpjekjet për të marrë pjesë në Aksion që janë iniciuar dhe/ose kompletuar përtej periudhës kohore të Aksionit, p.sh., jashtë periudhës kohore nga 1.04.2019 deri 31.10.2019.

15.4. Daikin Airconditioning Central Europe nuk do të jetë përgjegjës për dërgesat e vonuara të shkaktuara nga shërbimi i korierit.

15.5. Daikin Airconditioning Central Europe nuk do të jetë përgjegjës për asnjë dëm të shkaktuar nga fituesi dhe/ose pala e tretë në lidhje me këtë çmim. Pjesëmarrësit e kuptojnë dhe pranojnë se Daikin Airconditioning Central Europe nuk do të jetë përgjegjës për asnjë lloj dëmi ose lëndimesh të shkaktuara nga pjesëmarrësit ose nga palë të treta si rrjedhojë e shfrytëzimit të çmimit. Në qoftë se fituesit e nominuar përfutrojnë ndonjë lëndim si rrjedhojë e përdorimit normal të çmimit, ata do të duhet t'i drejtohen prodhuesit sipas informacioneve të specifikuara në vërtetimin e garancisë, të cilat mund të lexohen dhe shkarkohen nga uebfaqja e prodhuesit duke e klikuar linkun vijues: www.apple.com/en.

15.6. Daikin Airconditioning Central Europe nuk është përgjegjës në asnjë mënyrë për dëmet direkte ose indirekte që rrjedhin nga pjesëmarrja në këtë Aksion.

15.7 Daikin Airconditioning Central Europe ka të drejtën e patjetërsueshme për të anuluar Aksionin në çdo kohë, përmes njoftimit të shpallur në uebfaqen www.daikin.al, në qoftë se Daikin Airconditioning Central Europe zbulon keqpërdorime, shkelje të rregullave ose rrethana të tjera që kërkojnë anulimin e Fushatës. Në rrethana të tilla, Daikin Airconditioning Central Europe nuk do t'ju ketë borxh pjesëmarrësve asnjë kompensim që kanë pësuar humbje materiale/jo materiale direkte/indirekte ose humbje të fitimit si rrjedhojë e anulimit të Aksionit.

ZËVENDËSIMI DHE RIBLERJA E ÇMIMEVE

16. Të gjitha çmimet janë nominale dhe nuk mund t'ju transferohen palëve të treta para se ato të pranohen.

PRIVATËSIA

17.1. Aksioni po realizohet në pajtueshmëri me kërkesat dhe dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale. Organizatori, si Operator i të Dhënave Personale, detyrohet, në bazë të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, të grumbullojë, ruaj dhe përpunojë të dhënat personale që pjesëmarrësit i sigurojnë për anketën për qëllimet vijuese: realizimin e anketës, organizimin e pjesëmarrjes në Aksionin, shpalljen e fituesve, akordimin e çmimeve dhe plotësimin e detyrimeve ligjore, si dhe transmetimin e materialit për marketing (në qoftë se pjesëmarrësit janë prononcuar qartësisht për këtë në kuptimin e Nenit 17, paragrafi 4 më poshtë). Organizatori deklaron dhe garanton se të dhënat personale të individëve (p.sh., emri, mbiemri, e-mail adresa, adresa fizike) nuk do të përpunohen për qëllime tjera përveç atyre të specifikuara në këtë Nen. Vetëm deri në atë shkallë që është e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e tatimit, organizatori mund të kërkojë numër serik dhe numër të dokumentit të identifikimit, si dhe numrin amë që i përket fituesit në këtë Aksion.

17.2. Të dhënat personale të pjesëmarrësve mund t'u dorëzohen partnerëve të kontraktuar të organizatorit të fushatës (të cilët do t'i përpunojnë të dhënat në pajtueshmëri me udhëzimet e organizatorit), partnerëve të tjerë të kontraktuar, kompanive që janë në grup të njëjtë me organizatorin, organeve kompetente, në pajtueshmëri me ligjet aktuale dhe publikun (lidhur me fituesit). Organizatori mund të përcjell të dhëna personale në shtete të tjera në kuadër të Bashkimit Evropian (për shembull, kompanive të tjera në grupin e njëjtë). Organizatori duhet të ndërmerr të gjitha masat e domosdoshme për të siguruar se të dhënat personale mbrohen në mënyrë të përshtatshme, pa dallim se ku duhet të dorëzohen.

17.3. Me pjesëmarrjen në këtë anketë dhe me sigurimin e vullnetshëm të të dhënave personale organizatorit, varësisht nga opsioni i shprehur për komunikimin e marketingut, pjesëmarrësit japin pëlqim që të dhënat e tyre të regjistrohen në bazën e të dhënave të organizatorit, si dhe ai ose personat juridik të autorizuar nga ai do t'i përpunojnë të dhënat dhe do t'i shfrytëzojnë në të ardhmen për t'i informuar pjesëmarrësit rreth prodhimeve, ofertave, promocioneve të reja, si dhe reklamave dhe fushatave të marketingut. Organizatori obligohet t'i fshijë të dhënat e pjesëmarrësve të cilët nuk janë shprehur për atë opsion.

17.4. Në qoftë se pjesëmarrësit kanë dhënë pëlqimin e tyre të veçantë për këtë, atëherë Organizatori do t'i shfrytëzojë të dhënat personale për qëllimet marketingu që t'u ofrojë informacione pjesëmarrësve rreth aksioneve të ardhshme, që t'u dërgojë materiale reklamuese dhe/ose promovuese dhe/ose kampione nga Organizatori, kompanive të tjera në grup ose partnerëve të kontraktuar. Organizatori gjithnjë do të respektojë zgjedhjen e kontaktit të pjesëmarrësve, përfshi dhe opsionin për të mos pranuar më mesazhe promovuese, në qoftë se pjesëmarrësit e njoftojnë Organizatorin për këtë opsion. Këto opsione mund të përcillen në çdo kohë.

17.5. Çdo pjesëmarrës ka të drejtë qasjeje dhe përmirësimi të të dhënave personale të tij/saj në pajtueshmëri me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale. Çdo pjesëmarrës ka të drejtë të kërkojë me shkrim nga operatori i të dhënave personale në office@best-xp.com që të fshijë, korrigjojë ose bllokojë çfarëdo të dhëne personale përpunimi i të cilave nuk iu përmbahet dispozitave ligjore. Pjesëmarrësit kanë të drejtë të kundërshtojnë përpunimin e të dhënave të tyre personale në bazë legjitime dhe të arsyeshme në pajtueshmëri me dispozitat ligjore (lidhur me përpunimin e të dhënave për qëllime marketingu direkt, falas dhe pa asnjë arsyetim), si dhe kanë të drejtë t'i drejtohen Organit Mbikëqyrës Kombëtar për Përpunim të të Dhënave Personale ose gjykatës kompetente.

17.6. Refuzimi për të siguruar të dhënat tuaja personale në pajtim me Kushtet dhe Rregullat e përcaktuara këtu ose sigurimi i pakompletuar ose i pasaktë i atyre të dhënave nënkupton që nuk do të mund të merrni pjesë në këtë Aksion.

GABIMET NË MATERIALET PROMOVUESE

18. Në rast të ndonjë mospërputhjeje ndërmjet dispozitave të cekura në materialet reklamuese dhe këtyre Kushteve dhe Rregullave, do të vlejë këto Kushtet dhe Rregulla.

DISPOZITA TË TJERA

19.1. Pjesëmarrësit në këtë Aksion duhet t'ju përmbahen dispozitave të këtyre Kushteve dhe Rregullave që janë shpallur në www.daikin.al. Daikin Airconditioning Central Europe e ruan të drejtën për t'i ndryshuar ose plotësuar këto Kushte dhe Rregulla në çdo kohë. Ndryshmet do të hynë në fuqi pas shpalljes së tyre në uebfaqen vijuese: www.daikin.al. Me pjesëmarrjen në këtë Aksion, pjesëmarrësit i nënshtrohen Kushteve dhe Rregullave dhe pajtohen t'i përfillin ato.

19.2. Mosmarrëveshjet ndërmjet Organizatorit dhe pjesëmarrësve do të zgjidhen me marrëveshje miqësore.